



Fletinformacion për çështjen gjyqësore

Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës (Numri i çështjes KSC-BC-2020-04)

PJETËR SHALA



Anëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) i stacionuar në Kukës, Shqipëri

Aktakuza	U konfirmua më 12 qershor 2020; versioni i redaktuar u bë publik më 15 prill 2021. Aktakuza a korrigjuar u dorëzua më 1 nëntor 2021. Aktakuzën më të fundit mund ta gjeni këtu .
Gjykatës	Gjykatësi i procedurës paraprake: Nikola Giju Trupi Gjykses I: gjykatësit Mapi Feld-Folia (kryesuese), Roland Dekers, Zhilber Biti, dhe Vladimir Mikula (rezervë)
Arrestimi/Transferimi/ Paraqitja e parë	U arrestua më 16 mars 2021 në Belgjikë dhe u transferua në Hagë më 15 prill 2021. Paraqitja e parë u mbajt më 19 prill 2021
Informacion i përgjithshëm	Krimet e paraqitura në aktakuzë ndodhën në kontekstin e konfliktit të armatosur dhe kishin lidhje me këtë konflikt në Kosovë ndërmjet UÇK-së dhe forcave të Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) dhe të Republikës së Serbisë, ndër të cilat njësite të Ushtrisë Jugosllave, njësite policore dhe njësite të tjera të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe grupe të tjera që luftonin në emër të RFJ-së dhe Serbisë. Krimet për të cilat akuzohet Shala u kryen përafërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, kundër personave që u mbajtën të ndaluar në fabrikën e metalit në Kukës (Shqipëri), që pretendohet se përdorej prej UÇK-së. Sipas aktakuzës, viktimat e këtyre krimeve ishin të gjithë shtetas të RFJ-së dhe persona të cilët nuk merrnin pjesë aktivisht në luftime.
Akuzat	Shala ngarkohet me përgjegjësi penale individuale (neni 16(1)(a) i Ligjit) për krime lufte (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme, sikurse përcaktohet në nenin 14 të Ligjit).
Numri i viktimave pjesëmarrëse	8
Faza e çështjes gjyqësore	Gjykimi

Procedurat para Dhomave të Specializuara të Kosovës

PROCEDURA PARAPRAKE

Më 14 shkurt 2020, pas njoftimit të bërë nga Prokurori i Specializuar se kishte ndër mend të niste procedim penal, Kryetarja caktoi gjykatësin Nikola Giju si gjykatës të procedurës paraprake.

Më 12 qershor 2020, gjykatësi i procedurës paraprake konfirmoi aktakuzën kundër Shalës dhe lëshoi “Fletarrestim për z. Pjetër Shala” dhe “Urdhër për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara”.

Më 19 qershor 2020, Prokurori i Specializuar dorëzoi aktakuzën e konfirmuar me redaktime, sikurse u autorizua nga gjykatësi i procedurës paraprake.

Më 19 prill 2021, Shala pati paraqitjen e tij të parë para gjykatësit të procedurës paraprake dhe u vetëdeklarua i pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës.

Më 18 tetor 2021, gjykatësi i procedurës paraprake miratoi pjesërisht mocionet e Mbrojtjes dhe urdhëroi ZPS-në që të ndryshojë aktakuzën në mënyrë që të ofrojë nivelin e kërkuar të konkretitetit dhe të qartësisë lidhur me pjesëmarrjen personale të të akuzuarit në incidente. ZPS-ja e dorëzoi aktakuzën e korrigjuar më 1 nëntor 2021.

Më 15 dhjetor 2021, gjykatësi i procedurës paraprake miratoi kërkesën e një individi për t’u pranuar si viktimë pjesëmarrëse në procesin gjyqësor. Më 11 gusht 2022, në vendimin e tij të dytë në lidhje me pjesëmarrjen e viktimave, Gjykatësi i Procedurës Paraprake pranoi një person tjetër si viktimë pjesëmarrëse në procesin gjyqësor në këtë çështje. Gjashtë viktima të tjera u pranuan më 19 shtator 2022. Më 9 shkurt, Trupi Gjyqësor vendosi që procedurat për dëmshpërblim dhe ato penale do të zhvillohen njëkohësisht në këtë çështje dhe se, në rast të shpalljes fajtor, Trupi Gjyqësor nuk do t’i referojë viktimat për padi civile në gjykatat e Kosovës, në përputhje me nenin 22(9) të Ligjit dhe rregullës 167 të Rregullores, por do të nxjerrë një Urdhër për Dëmshpërblim, në përputhje me nenet 22(8) dhe 44(6) të Ligjit.

Më 28 janar 2022, ZPS-ja e dorëzoi si rreptësisht konfidenciale dhe ex parte dosjen e vet paraprake. Versioni konfidencial i redaktuar i dosjes paraprake të Prokurorisë u dorëzua më 31 janar ndërsa versionin me më pak redaktime (ende konfidencial) u dorëzua më 8 shkurt 2022. Më 14 prill 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar dorëzoi versionin e redaktuar publik të dosjes paraprake të saj. Më 21 prill 2023, u dorëzua versionin i redaktuar publik i dosjes paraprake të Mbrojtjes.

Më 14 prill 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, në urdhrin e tij gojor, caktoi 31 gushtin si datë paraprake për kalimin e dosjes trupit gjyqësor. Më 20 korrik 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake caktoi 21 shtatorin 2022 si datë të re paraprake. Më 15 shtator 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake njoftoi Kryetaren se dosja e çështjes do të jetë gati për t’u kaluar më 21 shtator 2022.

Më 21 shtator 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi dosjen e çështjes Trupit Gjyqësor I. Konferenca përgatitore për gjykimin u mbajt brenda periudhës 18-20 tetor 2022.

PROCESI GJYQËSOR

Gjykimi filloi më 21 shkurt 2023 me deklaratat hyrëse të Prokurorit të Specializuar, të përfaqësuesit të viktimave dhe të Mbrojtjes. Më 6 korrik 2023, ZPS-ja e mbylli çështjen e vet. Më 21 gusht 2023, Mbrojtësi i Viktimave paraqiti provat. Konferenca Përgatitore e Mbrojtjes u mbajt më 24 dhe 25 gusht 2023. Më 15 shtator 2023, Trupi Gjyqësor hodhi poshtë mocionin e Mbrojtjes për rrëzimin e akuzës për vrasje të paligjshme (pika 4), në bazë të rregullës 130 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të DHSK-së. Paraqitja e provave prej Mbrojtjes nisi më 20 shtator 2023.

Zyra e Prokurorit të Specializuar

Filipo De Miniqis, Gaja Pergolo, Eva Vajler

Mbrojtja

Zhan-Lui Zhilisen (Mbrojtës), Muhamed Hedi Auini (Bashkëmbrojtës), Leto Kariolu (Bashkëmbrojtëse)

Mbrojtja e viktimave

Sajmon Loz (Mbrojtës), Maria Raxhiovka (Bashkëmbrojtëse)